

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi, Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit SH.S. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par. 1 i KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit SH.S. av. I.Q. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.59/2018 datë 15.08.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 03.01.2019 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit SH.S., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.59/2018 datë 15.08.2018 **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.59/2018 datë 15.08.2018, të akuzuarin SH.S. e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par. 1 i KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim burgu ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim do ta vuaj ne afat prej 15 ditëve pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Konform nenit 273 par.5 të KPPK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme: substanca e llojit marihuan në peshë prej 7.13 gram, pako e tabletave me mbishkrim “Tramadol”. Obligohet i akuzuari që të paguaj taksën në shumë prej 50 euro ne Fondin për Kompensimin e Viktimave te Krimet. Obligohet i akuzuari që ti paguaj gjykatës shpenzimet për paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 euro në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit SH.S. av. I.Q., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën. aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj sa i përket sanksionit penal dhe te akuzuarit ti shqiptoj një dënim më të ulët me te cilin do te arrihej qëllimi i dënimit.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën nuk prezantoi Prokurori i Apelit edhe pse i ftuar me rregull, kurse prezent ishte i akuzuari SH.S. dhe mbrojtësi i tij av. I.Q.. Mbrojtësi mbeti pranë ankesës së parashtruar me shkrim, i akuzuari mbështeti fjalën e mbrojtësit.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.546/2018 të dt. 11.12.2018 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit SH.S. av. I.Q., të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit SH.S. av. I.Q. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e mbrojtësit nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Mbrojtja në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të mbrojturit të tij nuk i ka marrë parë për bazë rrethanat lehtësuese edhe pse i ka potencuar në aktgjykim, duke pas parasysh mënyrën e kryerjes së këtyre veprave, pendimin e thellë të kryesit, pranimin e fajësisë me vullnetin e tij të plotë, gjendjen e tij pasi ai ka qenë përdorues dhe në momentin e kryerjes se veprës ka qenë nën ndikim të drogës andaj ai nuk ka qenë në gjendje të kontrolloj veprimet e veta. Sipas mbrojtjes vet fakti se e ka pranuar fajësinë konsiston se edhe penduar thellë i akuzuari për veprat e kryera, i akuzuari SH.S. nuk ka qenë i dënuar asnjëherë për asnjë vepër penale dhe se është hera e parë që ballafaqohet me një vepër penale i njëjti ka pasur sjellje korrekte si ndaj gjykatës i akuzuari ka kërkuar falje gjyqtarit për rastin që i ka ndodhur.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat drejtë i ka vlerësuar Gjykata e shkallës së parë dhe atë pranimin e fajësisë, se është i pa punë, i moshës së re, ndërsa si rrethanë rënduese vlerësoj prirjen e të pandehurit për veprat penale të kësaj natyre vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së

përgjegjesisë penale të akuzuarit si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.576/18, më 03.01.2019

Procesmbajtës,  
Eroll Gashi

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja  
1. Mejreme Memaj\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi\_\_\_\_\_

3. Tonka Berishaj \_\_\_\_\_